



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1327/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Hib Petrol Sh.P.K., me seli në magjistralen Ferizaj- Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.K. dhe G.V. avokat nga Prishtina, kundër debitorit të përmbarimit Alba Group Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Musa Tolaj”, nr. 3, lidhur me çështjen përmbarimore pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kreditorit Hib Petrol Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, në piken I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar propozimi mbi kthimin e gjendjes e mëparshme i parashtruar nga kreditori Hib Petrol Sh.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës ndaj Aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, ndërsa në piken II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që ta hedh poshtë ankesën e kreditorit Hib Petrol Sh.P.K., i parashtruar kundër aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, si e pasafatshme.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kreditori ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale, me propozimin që aktvendimi ankimor i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023 të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose të ndryshohet.

Përgjigje në ankesë, nuk ka paraqitur debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Hib Petrol Sh.P.K., ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturave në vlerën prej 9,799.58€ si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh.

Përmbaruesi Privat Valdrin Beka me urdhrin përmbarimor P.nr.326/2021, të datës 16.03.2021, e ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturave, për shumën e përgjithshme prej 9,799.58€.

Debitori ka paraqitur prapsim me arsyetimin se propozimi nuk paraqet bazë për propozim pasi që dokumentet në bazë të së cilës është marr vendimi përmbarues ose urdhëri përmbarues, pra nuk janë në përputhje me nenin 37 të LPP-së pasi që fatura duhet të jenë në origjinal apo kopje të vërtetuar, ku gjithashtu nuk ka as vulën e pranimit të debitorit dhe asnjë konfirmim se janë pranuar nga debitori, prandaj i ka propozuar gjykatës shfuqizimin e urdhrit dhe të aprovet prapësimi në tërësi i bazuar.

Kreditori i përmbarimit i cili ka theksuar se me datën 08.05.2023 e ka pranuar Aktvendimin KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, ndërsa me datën 09.06.2023 ka paraqitur kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës, duke theksuar se pranimi i shkresave nuk është bërë sipas nenit 104 të LPK-së, ngase nuk është pranuar nga personat e autorizuar pranë kreditorit, me propozimi që ta aprovoj kërkesën për kthim në gjendjen të mëparshme dhe ankesa e kreditorit të trajtohet, kësaj kërkesë për kthim në gjendjen të mëparshme, ia ka bashkangjitur edhe mjetin juridik përkatësisht ankesën, ku gjithashtu duke cekur se të gjitha faturat janë të bazuara sipas kushteve ligjore nga LPP-ja.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, në piken I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar propozimi mbi kthimin e gjendjes e mëparshme i parashtruar nga kreditori Hib Petrol Sh.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës ndaj Aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, ndërsa në piken II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që ta hedh poshtë ankesën e kreditorit Hib Petrol Sh.P.K., i parashtruar kundër Aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1023/22 të datës 14.07.2023, si e pasafatshme, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivit të të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare e duke pasur parasysh neni 129 të LPK-së fletë dorëzimi i shkresave citon se : *“Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”,* për faktin që vërtetohet se fletë kthesa e cila gjendet në shkresa të lëndës e cila është nënshkruar nga punëtori i kreditori, në kuptim të nenit 104 para.1 të LPK parashihet se : *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit e punës”* pra rezulton që komunikimi me kreditorin është zhvilluar konform dispozitive të LPK-së, pra në munges të provave të cila mbështesin kërkesën e kreditorit për kthim në gjendjen e më parshme, gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkakë të arsyeshëm si rezoluta i të cilit është pamundësuar kreditorit që të ushtroj ankesën

ndaj aktvendimit KPPP.nr. 1023/22 të datës 23.08.2023. Meqenëse komunikimi me kreditorin i datës 08.05.2023 është konsideruara i rregullt, dhe kërkesa për kthim në gjendjen e më parshme rezulton te jetë e pabazuar, në kuptim të nenin 77 para. 2 të LPP-së përcaktohet se : *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*, prandaj kreditori ka pranuar vendimin me datën 08.05.2023, m ndërsa ankesa ndaj të njëjtit e ka paraqitur me datën 09.06.2023, prandaj rezulton që e njëjta është paraqitur jasht afatit të përcaktuar ligjor. Në anën tjetër sipas neni 186 par.1 të LPK-së citon se : *“Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”*, ndërsa para. 2 përcakton se : *“Ankesa është e pa afatshëm po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*. Prandaj gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën e kreditorit.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbartimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar propozimin mbi kthimin në gjendjen e mëparshme të parashtruar nga ana e kreditorit si të pa afatshëm për shkak të humbje së afatit për paraqitjen e ankesës, si dhe kur e ka hedhur poshtë ankesën e kreditorit si të pa afatshëm , për arsye se duke u bazuar në dispozitat e nenit 17 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*.

Gjykata Komerciale , Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejta ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 68 par.2 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimin dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë”*. Prandaj, kjo gjykatë vlerësoje propozimin e debitorit dhe vërtetoje se i njëjti është i pa afatshëm, me arsyetimin së në bazë të shkresave të cilat gjendet në shkresat e lëndës, flete kthesa vërtetohet se kreditori aktvendimin e ka pranuar me datën 08.05.2023, kurse i njëjti nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të parashtruar mjetin juridike ndaj aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit.

Kjo gjykatë, po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur edhe kur ka vendosur si në pikën II të dispozitivit, kur e ka hedhur poshtë ankesën si të pa afatshëm, sepse në bazë të shkresave të lëndës konstatohet se kreditori nuk ka vepruar brenda afati ligjore të përcaktuar për paraqitjen e ankesës kundër vendimit mbi lejimin e përmbartimit. Prandaj Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se duke u bazuar në dispozitat e nenit

Në anën tjetër sipas neni 186 par.1 të LPK-së citon se : *“Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”*, ndërsa para. 2 përcakton se : *“Ankesa është e pa afatëshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*. Prandaj gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën e kreditorit.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore t për të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta. dhe rrjedhimisht ankesa e kreditori rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e shkallës së dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.1327/23, me datën 05.03.2024**

**Gj y q t a r,  
Faton Bajrami**